

	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE	DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJË
Nr./nr./Br. sh.	58
Date/Datum	20. 04. 2021
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE	



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA**



**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE**

**Ekstrakt nga procesverbal i mbledhjes së tretë - III - të, të rregullt të Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 07.04.2021, ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës.**  
**Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës:** Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës, Remzi Shala, Arjeta Jashari, Mirvete Gërguri, Ilir Hasani, Jetmir Berisha, Albert Jasharaj, Miranda Shabani, Sabri Rexhepi, Durim Hajra, Doruntina Jashari, Eglantina Azemi, Aida Alimi, Arjana Zogjani, Naser Graçevci, Migjen Kolshi, Driton Ademi, Ali Ismaili, Driton Hasolli, Shaban Ademi, Mensur Graçevci, Hysni Hasani, Suhat Ademi dhe Ljubisa Qirkoviq.

**Mungon:** Sabit Bullatovci, Ali Zogjani dhe Mehdi Lahu.

**Kryetari i Komunës dhe Drejtoret e Drejtive të Komunës:** Fadil Krasniqi - Nënkyetar i Komunës, Ekrem Berjani - Drejtore i Zhvillimit Ekonomik, Jakup Dumani - Drejtore i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Maliq Berisha - Drejtore i Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, Adnan Bullatovci - Udhëheqës i Drejtorisë së Arsimit, Fatlum Berisha - Udhëheqës i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Besnik Hykolli - Udhëheqës i Drejtorisw së Inspektoratit.

**Të tjerë:** Përfaqësuesit e Shoqërisë Civile dhe përfaqësuesit e Kompanisë INSI: Mevlana Biçaku, Ramadan Duraku dhe Gëzim Hoxha.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

**REND DITE**

1. Aprovimi i ekstrakteve të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 29.01.2021 dhe 01.03.2021.
2. Prezantimi dhe shqyrtimi i punës nga Kompania INSI për 'Planin e Mobilitetit' për territorin e Komunës së Fushë-Kosovës - diskutim dhe analizim.
3. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
4. Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2020.
5. Propozim për shqyrtimin e Raportit Financiar për buxhetin e shpenzuar në vitin 2020.
6. Propozim për formimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-Rregullores për organizimin, bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
7. Propozim për formimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
8. Propozim për formimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-Rregullores për Shërbime publike dhe Projekt-Rregullores për menaxhimin e varrezave.

9. Propozim për plotësimin e Komitetit për Komunitete.
10. Të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës lexoi pikat e rendit të ditës të parapara për shqyrtim në mbledhjen e sotme dhe pikën shtesë: Propozimin e Kryesuesit të Komitetit për Komunitete për plotësimin e Komitetit për Komunitete, me një anëtar të ri, përfaqësues i komuniteti egjiptian. Po ashtu kërkoi nga ju që ta mbajmë një minutë heshtje për mësuesen e parë nga fshati Bardh i Madh Bahrije Gërguri.

Në vazhdim u mbajtë një minutë heshtje për ta nderuar, të ndjerën mësuesen Bahrije Gërguri nga fshati Bardh i Madh.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim rendin e ditës së propozuar për mbledhjen e sotme, me pikën shtesë.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e katër anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me unanimitet të votave e aprovoi për shqyrtim rendin e ditës së propozuar me pikën shtesë.

**Pika e parë (1) - Aprovimi i ekstrakteve të procesverbalit nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës e datës 29.02.2021 dhe 01.03.2021.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** Tani i kemi për aprovim ekstraktet e procesverbaleve nga dy mbledhjet e kaluar të Kuvendit të Komunës, të mbajtura me datën 29.01.2021 dhe 01.03.2021, ju pyes juve tani nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim për diskutimet tuaja.

Kuvendit të Komunës i qiti në votim për aprovim ekstraktet e procesverbaleve nga dy mbledhjet e kaluar të Kuvendit të Komunës, të mbajtura me datën 29.01.2021 dhe 01.03.2021.

U votua me: dymbëdhjetë vota ‘për’, dhjetë ‘kundër’ dhe një abstenim, gjithsej njëzet e tre anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave, i aprovoi ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e kaluar të Kuvendit të Komunës, të mbajtura me datën 29.01.2021 dhe 01.03.2021.

**Pika e dytë (2) - Prezantimi dhe shqyrtimi i punës nga Kompania INSI për ‘Planin e Mobilitetit’ për territorin e Komunës së Fushë-Kosovës - diskutim dhe analizim.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** E kemi për prezantim, diskutim dhe analizim nga përfaqësuesit e Kompanisë INSI ‘Planin e Mobilitetit’ për territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, ftoi profesorin z. Mevlana Biçaku, që të fillon me prezantimin e punës së deritanishme për hartimin e këtij plani.

**Mevlan Biçaku - Përfaqësues i Kompanisë INSI:** Përvendos të pranishmit në mbledhje. Kompania INSI ka punuar në hartimin e ‘Planit të Mobilitetit’ me Grupin Punues të Komunës së Fushë-Kosovës, të cilët i falënderojmë për kontributin e tyre dhe sot ne para juve anëtarëve të Kuvendit të Komunës, e shpalosim një përbledhje të punës. Në punën tonë kemi marrë parasysh direktivat e Bashkimit Evropian, librin e bardhë dhe librin e gjelbërtë, në aspektin ndërkombëtarë, në aspektin kombëtarë kordinimin e bashkëpunimit me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit

Hapësinor, Ministrinë e Infrastrukturës, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Drejtorinë e Rrugëve, në nivelin komunal, Kryetarin e Komunës, Kuvendin e Komunës dhe Drejtoritë përkatëse komunale. Këtu janë të përbledhura palët e interesit dhe qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës. Plani i Mobilitetit është një dokument strategjik, si vazhdimësi e dokumenteve të vlefshme të komunës, i mbështetur në Planin Hapësinor të Kosovës, Hartën Zonale të Kosovës, Strategjinë për sigurinë në rrugë 2015-2025, planin Zhviullimor Komunal, Planin Zhvillimor Urban, planet rregulluese dhe Hartën Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës, gjatë gjithë procesit është analizuar gjendje në territorin e komunës, kemi rianketuar një pjesë të qytetarëve, palët e interesit, lëvizjet ditore të automjeteve në qendrën e qytetit, madhësinë e objekteve dhe kemi paraparë një plan përfundim të analizimit të tre skenarëve si vijon: skenarin proaktiv, skenarin e mirëmbajtjes dhe skenarin liberal. Secili skenar është shqyrtuar duke e marrë parasysh dhe vlerësuar, rrjedhën e trafikut në Komunën e Fushë-Kosovës, lëvizjen e karakterit nacional në rrugën magjistrale M9, është konstatuar se kjo është rruga më e ngarkuar në nivelin e vendit. Janë vendosur kamerat dhe është vëzhguar lëvizja e automjeteve për një javë rreshthë, kemi bërë matjen e fleksibilitetit dhe lëvizjes së automjeteve, nëpër ditë të caktuar dhe në kohën e pikut të qarkullimit të tyre. Është konstatuar se nuk ka një barbarësi të lëvizjes së automjeteve në ditë të javës, dita e hënë është dita më e ngarkuar më 30.460 automjete, ndërsa dita me më pakë lëvizje është dita e shtune me rreth 25.000 automjete në qarkullim. Qarkullimi me frekuentimin më të madh të automjeteve, është ndërmjet orës 09:00h-10:00h të paraditës dhe orës 16:00h dhe 17:00h të pasditës, ku kalojnë mbi 2.000 automjete vetëm në njërin drejtim të rrugës, ndërsa në dy drejtimet mbi 4.500 automjete. Kemi konstatuar se 91% të njerëzve e përdorin automjetet e tyre, vetëm 1% trafikun urban dhe 8% janë automjete që mirren më çështje komerciale dhe furnizim të bizneseve. Ndryshe nga ditët e punës në ditët e vikendit, lëvizjet në relacionin Prishtinë/Pejë janë - 29%, ndërsa në relacionin Pejë/Prishtinë - 21% dhe këtu kemi një barbarësi në qarkullim. Autostradën e përdorin mbi 11.000 në drejtim të Prishtinës, ndërsa në drejtim të Pejës 28.000 automjete. Në qendrën e qytetit kalojnë mbi 20.000 automjete vetëm në njërin drejtim, ndërsa në dy drejtimet rreth 45.000 automjete brenda 24h. Kemi vlerësuar se pikat kyqe duhet të kenë ulje të kapacitetit me disnivell në Fushë-Kosovë te rrethi në qendër sepse aty kalojnë 28.000 automjete në ditë. Mbingarkesa në qendër është 123%. Një trajtim duhet të bëhet edhe të shkolla 'Mihal Grameno' te semafori i kthimit majtas, aty duhet të jetë mbinivel. Në qendër tek rrethi kalojnë mbi 550 këmbësorë brenda një ore, ndërsa te shkolla 'Mihal Grameno' kalojnë mbi 400 këmbësorë brenda një ore. Pra ne kemi analizuar shkallën e lëvizjes së mjeteve të motorizuar dhe këmbësorëve, kemi analizuar infrastrukturën e transportit, kryqëzimet, sidomos te udhëkryqi, ku në drejtim të Pejës është 56%, ndërsa në orët e pikut është deri në 87%, këto matje i kemi bërë me soëtverin sintrifik në secilin udhëkryqë në kohë reale, në qendër ngarkesa tanë është 124%, ndërsa te mbikalimi te shkolla ngarkesa është 78%, në kthimin majtas në orët e pikut, ngarkesë të madhe ka edhe tek Eurogoma dhe tek rrëthrrotullimi. Është vlerësuar se Fushë-Kosova është një territor i përshtatshëm përlëvizjen me biçikleta pas rregullimit të infrastrukturës. Koncentrimi më i madh i qarkullimit është te rrëthrrotullimi, te shkolla dhe në rrugën 'Dardania' në Fushë-Kosovë. Duhet ta kemi parasysh se këtu është edhe rrjeti hekurudhor, statcioni kombëtarë, terminali multimodal në fshatin Miradi e Epërme, ku hyn korridori panevropian që është duke u zgjeruar me financim nga BERZH-i hekurudha: Hani i Elezit/Fushë-Kosovë, Fushë-Kosovë/Mitrovicë dhe Mitrovicë/Leshak në vijën panevropiane që ndërlidhet me korridorin dhjetë Mitrovicë/Shkup. Sistemi i qarkullimit duhet të ndërlidhet me hekurudhë, ku duhet të mirret parasysh edhe Prishtina metropolitane, tereni përpunë është i lehtë sidomos në zonën Prishtinë/Fushë-Kosovë/Aeroport, ky studim është bërë nga një

Kompani në gushtin e vitit 2020, që parasheh ndërlidhjen e Hekurudhës me Aeroportin. Lidhja hekurudhore do të bëhet edhe me terminalin multimodal, i cili do të modernizohet me teknologjinë e nevojshme. Në Fushë-Kosovë ka pak parkingje, një është në rrugën ‘Nënë Tereza’ në pronën komunale dhe një tek hekurudha, në pronën e hekurudhës, pjesa tjeter është pa hapësira për parking. Në ndërtimet e realizuara, garazhat nëntokësore janë ndërtuar pa kritere dhe aty janë të vendosura shenjat, se kjo është vetëm për banorët e ndërtesës, në pronësi private. Tani shkurtimisht do të përmendi disa faktorë tjerë, lidhur me sigurinë në trafik, është konstatuar se 92% e rasteve në Qarkoren e Prishtinës shkaktohen nga faktori njeri, mbrojtja e ambientit tani bëhet në dy statcione matëse të IHMK-së, njëra në Prishtinë dhe njëra në zonën industriale, ka edhe të tjera matje që bëhen nga Xhajka Joponeze dhe OJQ-ja ‘Bone vetë’, ku matet kualiteti i ajrit, është konstatuar se në perimetrin Prishtinë/Fushë-Kosovë/Obiliç, ajri është i ndotur në kohë sezionale. Në mungesë të një planifikimi adekuat strategjikë, shkalla e motorizimit, lëvizjet e njerëzve, nuk kanë një rrjedhë logjike, nuk përdoret trafiku urban sa duhet. Prishtina e ka të miratuar një plan të mobilitetit por nuk e ka në zbatim deri tani. Ne kërkojmë që të mbajmë takime të përbashkëta me punëtorët, që ta kemi një vizionim për zhvillimin e trafikut. Në Fushë-Kosovë ka një zonë urbane të qëndrueshme dhe tërheqëse për jetesë, sepse cilësia e jetësës është e lartë, ka një qasje të lehtë dhe të sigurtë të lëvizjes deri në destinim për secilin qytetarë. Në secilin skenar që do ta marrim, duhet të ketë një lëvizje aktive të ecjes dhe çiklizmit. Ne duhet të caktojmë qëllimin në skenarin që e miratojmë, të marrim përparësitë e tij dhe t'i vëjmë në funksion të qarkullimit më të mirë në qytetin e Fushë-Kosovës, të caktojmë objektivat me modelin SMART, thjeshtë të kemi lëvizje aktive, me mjete jo motorike. Me skenarin liberal kërkohet të fuqizohet lëvizja e çiklistëve, ose të mbahet gjendja ekzistuese sipas skenarit të mirëmbajtjes, që nënkupton mirëmbajtje pa zhvillim. Por në secilin skenar duhet të mirret parasysh rruga tranzit dhe rruga përgjatë hekurudhës, mirëpo me rrugën tranzit në drejtim të Pejës, duhet të kihet kujdes në mirëmbajtjen funksionale të bizneseve. Skenari liberal parasheh tërheqjen e automjeteve në drejtim të qendrës, te rrethi, skenari i mirëmbajtjes parasheh mbajtjen e gjendjes ekzistuese, pa ndonjë ndryshim substancial. Vlerësimi i secilit skenar duhet të bëhet me një analizë paraprake para dakordimit për skenarin që do ta zbatojmë.

**Ramadan Duraku - Përfaqësues i Kompanisë INSI:** Përvendosim të pranishmit në mbledhje. Unë dua të jem i shkurtër, ne kemi aplikuar dokumentet model, kemi studiuar fizibilitetin e tyre, për rregullimin e trafikut tranzit dhe në qendër sipas soëtverit gjerman, ku pjesa urbane është ndarë në tetëmbëdhjetë zona të brendshme dhe pesë të jashtme. Kemi angazhuar studentët në pesë zona të caktuara urbane për hyrje dhe dalje në Komunën e Fushë-Kosovës. Është bërë kategorizimi i rrjetit të rrugëve dhe është ndërtuar modeli si pamje, me vëzhgim me kamera, kemi nxjerrë orët me kulm përcaktojnë domethënien e tyre. Në kordinim me Ministrinë e Infrastrukturës nëse ndërtohet rruga rruga e Uglarit, por këtu kemi gjetur se kjo unazë nuk krijon shumë efekte pozitive. Tani qarkullojnë dikun nga njëzet e pesë mijë deri në tridhjetë mijë automjete në ditë, trafiku alternativ ka ndikim pozitive vetëm me qarkore rrugore jashtë qytetit dhe rrugë alternative përgjatë Hekurudhës.

**Mevlan Biçaku - Përfaqësues i Kompanisë INSI:** Ne kemi vlerësimë të detajuara për secilin skenarë, por duhet në bashkëpunim me Grupin Punues të Komunës të definojmë, prioritetet dhe qëllimet, të identifikojmë problemet ekzistuese, rruga kryesore tani është e ngarkuar 124%, ne synojmë ta ulim në 87%. Kalimi i rrugës nga këmbësorët në vende të ndryshme, paraqet një kërcnim për jetën e tyre dhe sigurinë në trafik. Janë studiuar dhe analizuari shtatë fusha me rëndësi,

si parkingjet, mbrojtja e mjedisit, siguria në trafik e tjera. Disa çështje do të rregullohen me krijimin e rrugëve njëkahore në disa zona të dendura të qytetit.

**Gezim Hoxha - Përfaqësues i Kompanisë INSI:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne duhet ta kemi një zgjedhje opsionale që e bënë rregullimin e trafikut, rregullon udhëkryqet, në lagjen e Dardanisë jemi përcaktuar për rrugë njëkahore, për zonat brenda lagjes. Por zgjidhja më e mirë është rruga qarkore që e ulë qarkullimin nga 124% në 82%. Ne së bashku me përfaqësuesit e komunës duhet ta caktojmë skenarin më të mirë, pas një analizimi të mirëfilltë dhe jemi të hapur për sugjerime tjera, që duhet të analizohen.

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** Pas dhënies së varianteve për tre skenarët e mundshëm, që mund të përzgjidhen për aplikimit dhe rregullim të trafikut në komunën tonë, e hapi diskutimin për anëtarët e Kuvendit të Komunës.

**Remzi Shala:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Skenari i dytë ka edhe pengesa pronësore, që duhet të zgjidhen, në raport me modernizimin e Hekurudhës, ky fakt duhet të mirret parasysh paraprakisht para fillimit të punimeve në këtë skenar. Pjesa tjetër që është mjaft aktuale duhet të përshtatet me projektet zhvillimore aktuale dhe të ardhshme, sepse ka ndërtime të larta dhe këtu ka në qarkullim makineri të rëndë, edhe në rrugën kryesore edhe në rrugët tjera në brendësi të zonës urbane.

**Mevlan Biçaku - Përfaqësues i Kompanisë INSI:** Në rastin e parë duhet të rregullohet brezi përgjatë Hekurudhës, duhet të krijohet zona mbrojtëse, dihen veprimet e Komunës së Fushë-Kosovës dhe Infrakosit që duhet të rregullohen, sa i përket aspektit pronësorë dhe juridik. Ky planifikim e ka një orientim strategjik deri në vitin 2030.

**Mirvete Gërguri:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Struktura urbanistike e qytetit duhet të jetë e rregulluar mirë, sepse njerëzit që zbresin në Aeroportin Ndërkombëtarë të Prishtinës ne qytetin e parë Fushë-Kosovën, duhet ta shohin një infrastrukturë të mirë. Më intereson të dijë a keni bashkëpunuar me Korporatën Energetike të Kosovës për përdorimin e lëndes së parë, mazutit, naftës, e tjera, sepse rrugët po prishen nga peshat e larta. Është e mirë ideja e rrugës mbrojtjen e njerëzve, duhet të vendosen policët e shtrirë për ta zvogëluar shpejtësinë e automjeteve. Kush e merrë përgjegjësinë për mbikalime dhe nënkalime, për nivelin e ujërave nëntokësore, ne jemi në një teren të ulët. Ne duhet të flasim edhe për ngrohje të rrugëve, nga sistemi i termocentraleve, pastaj për urat e gjelbërtë, të gjitha këto fakte duhet të mirren parasysh.

**Mevlan Biçaku - Përfaqësues i Kompanisë INSI:** Pyetja e parë është shumë e rëndësishme, duhet të kontaktojmë me Korporatën Energetike të Kosovës, duhet ta kemi një ndërlidhje funksionale të Hekurudhës me zhvillimin e bizneseve, do të krijohet një linjë metropolitane: Prishtinë/Fushë-Kosovë/Aeroport. Po ashtu shumë e rëndësishme është edhe vendosja në vende adekuate e nënkalimeve dhe mbikalimeve për këmbësorë. Çështja e policëve të shtrirë mund ta qetëson pak trafikun e dendur, por nuk krijon një zgjidhje të përhershme, kjo nuk duhet të bëhet në lokacione 'ad hoc', pa studim.

**Naser Graçevci:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ju si kompani duhet ta keni një qasje profesionale, sepse këtu po tentohet të rregullohet trafiku deri në vitin 2030 dhe duhet ta gjeni, zgjidhjen adekuate për komunën tonë. Unë pyes, si e keni menduar lëvizjen e çiklistëve nëpër rrugët tona, meqë kushtet janë të përshtatshme? Po ashtu, më intereson të dijë, a është menduar caktimi i pushimoreve për të moshuarit, nëpër ndonjë kënd të caktuar në rrjedhën e rrugës kryesore.

**Ilir Hasani:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Nga Kompani INSI u prezantuan tri zgjidhje për ngarkesat në trafik, duhet të zgjidhet opsioni më i favorshëm për komunën tonë, në mënyrë

profesionale nga ekspertët, të planifikohet drejtë buxheti, burimet e financimit të rrugëve dhe infrastrukturës përcjellëse, nga niveli qendror dhe komunal.

**Mevlan Biçaku - Përfaqësues i Kompanisë INSI:** Një fokus shumë me rëndësi janë këmbësorët dhe shtegu i rrugës për çiklistë, varësisht nga skenari që e zgjedhim, pas shumë analizave me Grupin Punues të Komunës. Kosto e investimeve publike duhet të bëhet nga institucionet secila për pjesët që i takojnë. Kjo mund të bëhet nga Ministria e Infrastrukturës dhe partneritet publiko-privat.

**Driton Ademi:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ky është një prezantim i mirë, por materiali për ne është i mangët, është dashur që paraprakisht të na dorëzohen këto materiale. Nga prezantimi vërehen qartë mangësitë në planifikim dhe lëvizjen e lirë, lëvizjen e mjeteve të motorizuara, sigurinë në trafik, cilësinë e ajrit. Në këtë rast ne kemi një kolozion të ligjeve që i rregullojnë këto fusha në raport me vetëveten. Për këto çështje duhet të kemi një planifikim të mirëfilltë me kosto financiare të realizimit. Mua më intereson kuptimi profesional i skenarit që do të përzgjidhet për zbatim në komunën tonë, si do të bëhet ndërlidhja e tij me arsimin, ekonominë, bujqësinë, emërgjencat dhe shumë probleme tjera që mund të rrjedhin nga fusha të ndryshme, nëse nuk studiohen dhe analizohen si duhet. Sipas mendimit tim nga shpjegimet e dhëna opzioni më i mirë është skenari proaktiv me kalime mbi dhe nën nivel. Pyetja ime është cila është qasja e Ekzekutivit të Komunës dhe mbështetja politike që do t'i jepet këtij plani?

**Mevlan Biçaku - Përfaqësues i Kompanisë INSI:** Nga komuna janë formuar dy grupe të punës, grupi drejtues mbikëqyrës dhe një grup punues që ndihmon në hartimin e planit. Ne i kemi patur takimet e para, që kanë qenë gjithëpërfshirëse.

**Drejtori për Zhvillim Ekonomik:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ky plan duhet ta ketë edhe një ndikim të mirë tek bizneset private që janë kryesisht tregtare dhe shërbyese, pastaj në shëndetësi, arsim, lëvizjen e nxënësve në drejtim të shkollave, qasjen e tyre në rrugë, krijimin e një shtegu efektiv dhe të përdorshëm për çiklistë në rrugën kryesore ‘Nëna Tereza’ dhe rrugën ‘Dardania’. Ekonomia duhet ta ketë një balancim në zhvillim me infrastrukturën ekzistuese, krijimi i infrastrukturës së re shtesë duhet të jetë shumë kreativ dhe të ndërlidhet me zhvillimin.

**Albert Jasharaj:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Cili është mendimi juaj për krijimin e një rrerhrotullimi tek pompa e derivateve të naftës Kastrati në hyrje të Fushë-Kosovës nga drejtimi i Prishtinës, cili do të ishte ndikimi në rrjedhën e trafikut. Ky projekt-publik është përmendur si mundësi para disa muajve.

**Mevlan Biçaku - Përfaqësues i Kompanisë INSI:** Duhet të ketë një analizë të vlerësimit të lëvizshmërisë të automjeteve, këtu ka rëndësi caktimi i perimetrit të rrerhrotullimit, lëvizjen e mjeteve motorike nga drejtimi i Prishtinës, por aty nuk mund të krijuhet një zgjidhje efektive.

**Gëzim Hoxha - Përfaqësues i Kompanisë INSI:** Projektin ideorë për këtë projekt e ka Ministria e Infrastrukturës, ky projekt nëse realizohet duhet të ndërlidhet me skenarin, që e zgjedhim ne në Komunën e Fushë-Kosovës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës falënderoi përfaqësuesit e Kompanisë INSI, për prezantimin e ‘Planit të Mobilitetit’, që është në proces të hartimit të tij.

**Koha e pushimit prej 30 minutave.**

**Pika e tretë (3) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** E kemi pikën ‘Pyetje dhe përgjigje parlamentare’, ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës që të parashtrojnë për Ekzekutivin e Komunës nëse kanë ndonjë pyetje.

**Durim Hajra:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë i kam dy pyetje të reja për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, njëra është kërkesa e banorëve të rrugës '28 Nëntori' për rregullimin e ndriçimit publik. Pyetja tjetër ka të bëjë me menaxhimin e mbeturinave në rrugën 'Dardania', ku ka edhe mungesë të kontejnerëve. Ne do ta bëjmë edhe pyetjen e përhershme, sepse ka qenë edhe premtim, kur do të bëhet furnizimi me ujë të pishëm i fshatrave të Komunës së Fushë-Kosovës. Pyetja për Nënkyrytarin e Komunës, është për kompensimin e qytetarëve të prekur nga vërshimet e muajit janar, kur do të bëhet kompensimi i dëmeve në shtëpi të banimit dhe dëmeve në kulturat bujqësore. Për Drejtorinë e Planifikimit Urban, i kemi pyetjet për rregullimin e dëmeve në rrugën 'Metush Krasniqi', po ashtu edhe rrugën e 'Llapit', ku sidomos banorët e lagjes së njojur si Ish/Kolonia afër Hekurudhës, kanë shumë probleme në qarkullim dhe komuna nuk po i zgjidhë këto probleme. Pyetja për Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, ka të bëjë me moszbatimin e vendimit të Kuvendit të Komunës, për personat e prekur me virusin Covid - 19 dhe familjarët e tyre që kanë ndërruar jetë nga kjo sëmundje ngjitetë. Javën e kaluar unë me disa anëtarë/e të Kuvendit të Komunës, e kemi vizituar Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë për ta parë gjendjen atje dhe pastaj, e kemi zhvilluar edhe një komunikim me Drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, ku kemi dhënë sugjerimet tona për përmirësimin e gjendjes dhe kemi kërkuar që për trajtimin e pacientëve me virusin Covid - 19, të hapet Qendra e Mjekësisë Familjare në lagjen e 'Dardanisë', ku është hapi i parë i ynë në këtë formë, para marrjes së hapave tjerë për thirrjen e një mbledhje të jashtëzakonshme për gjendjen në shëndetësi.

**Doruntina Jashari:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë kërkoi që nga Drejtoria e Inspektoratit ta kemi një numër kontaktues, në mënyrë që qytetarët të lajmërojnë për parregullësitë në teren, siç është rasti për hudhjen e mbeturinave në rrugën 'Selim Graçevci' në Fushë-Kosovë, ku po hudhen mbeturina të egëra, unë këto pamje i kam edhe me foto dhe nuk kemi ku t'i dërgojmë. Unë dua ta parashtroi edhe një shqetësim të ngritur dje, në mbledhjen e Komitetit për Komunitete, ku ata kërkojnë që të bëhet rregullimi i shtratit të lumit Sitnica, sepse banorët e komuniteteve në lagjen 028 kanë shumë vështirësi.

**Migjen Kolshi:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne duhet ta kemi një informatë zyrtare se kush është Drejtori i ri i Inspektoratit, në mënyrë që ai të mirret me problemet e shumta që kërkojnë trajtim. Unë e kam një pyetje për Drejtorin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, kur do të zbatohet vendimi i Kuvendit të Komunës për pagesën e personelit shëndetësorë të punësuar në projektin e Karitasit? Deri tani kanë kaluar tre muaj dhe pagesat nuk kanë filluar, ne kërkojmë që këto mjete financiare të jipen për punëtorët në mënyrë retroaktive, sepse janë ndarë 60,000.00€, për të gjithë vitin 2021. Si do të veprohet në shëndetësi tani kur janë larguar tetë mjekë, a do të zëvendësohen ata, fluksi i pacientëve që kërkojnë trajtim shëndetësorë është i njejtë. Janë dy vende të lira, por konkursi nuk hapet, nëse nuk jepni përgjigje, ju po i ikni debatit dhe përgjegjësisë që e keni për menaxhim. Për Drejtorinë për Inspektorat është një vendim për rrënimin e objektit, ju Kompaninë e keni të kontraktuar për tre vite dhe mund ta kryeni këtë punë. Drejtorin e ri të Arsimit e pyesim, a do të shpallni konkursin për ndërrimin e Drejtorave të shkollave, ku disa prej tyre janë që nga paslufta, unë pyes, a do të veproni në këtë drejtim deri në fund të këtij mandate?

**Ilir Hasani:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Drejtorëve të ri të komunës i'u urojmë punë të mbarë dhe suksese. Unë i kam tre pyetje, e para është për Drejtorin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, a është në plan krijimi i një Qendre Rinore Inovative? A është funksionale Biblioteka e qytetit? Pyetja e fundit është lidhur me funksionimin e Këshillit të veprimit rinor, të zgjedhin Këshillin drejtues dhe të funksionojnë.

**Aida Alimi:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Edhe unë i uroi punë të mbarë dhe suksese Drejtorëve të ri të komunës. Kur do të hiqet nga rruga një shyllë e lakume në mes të rrugës, që po paraqet rrezik permanent për qytetarët e zonës. Po ashtu kërkoi nga Inspektorti i Komunës, që të mirret me eliminimin e dukurisë negative të prostitucionit, që për një kohë të gjatë, është duke u zhvilluar në lokalet afër Stadiumit të qytetit, këtë problem ne e kemi ngritur edhe në të kaluarën në Kuvendin e Komunës.

**Driton Ademi:** Ne kemi të drejtë si anëtarë të Kuvendit të Komunës ta dijmë, cila është arsyja për ndërrimin e Drejtorëve të Komunës, mospuna, rritja e shpenzimeve apo çështje tjera.

**Durim Hajra:** Unë e kam një pyetje lidhur me shfuqizimin e vendimit Nr. 151, pse nuk është i publikuar ne ueb-faqe, u sqarua se vendimet publikohen në ueb-faqe pas konfirmimit nga Ministria përkatëse. Po ashtu kërkoi nga Drejtoria e Arsimit, që ta bënë dezinfektimin e shkollave, në kohën e mësimit online që do të zgjatë deri me datën 18 prill. Po ashtu ta keni një kujdes për nxënësit që nuk kanë mundësi të marrin pjesë në mësimin online.

**Ali Ismaili:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një pyetje për Drejtorinë e Arsimit lidhur me konkursin për shkollën e fshatit Lismir, janë publikuar disa lista, nuk është zhvilluar fare testi me shkrim, lidhur me këtë çështje ka shkrime edhe në portaltet e Fushë-Kosovë, andaj ne e kërkojmë një sqarim, që të mos jemi të dezinformuar, apo të informuar keqë. Është bërë traditë që për vite me radhë të përkujtohen dëshmorët dhe martirët e lirisë së Kosovës, për këtë vitë ne nuk e kemi marrë asnjë ftesë nga komuna, unë i kam edhe familjarët e mi dhe duhet ta kem një ftesë për pjesëmarrje në këtë ceremoni.

**Nënkyryetari i Komunës:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Lidhur me pyetjen e anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Durim Hajra rrugën '28 Nëntori', po e dëmtojnë individët e pandërgjegjëshëm dhe atje duhet ta dërgojmë policinë për t'i eliminuar këtë dukuri. Nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, për kompensimin e dëmeve nga vërvshimet janë ndarë 140,000.00€ dhe ne së pari do t'i kompensojmë familjet, që uji ju ka hyrë brenda në shtëpi të banimit, në fund të muajit prill ose më së voni në fillim të muajit maj. Për kulturat bujqësore, vlerësimet janë bërë dhe janë dërguar në Ministrinë e Bujqësisë, Pyllatarisë dhe Zhvillimit Rural, deri tani nuk kemi ende ndonjë përgjigje konkrete. Lidhur me vendimin për përkrahjen financiare të personave të prekur me Covid - 19, vendimi është marrë pa mbulueshmëri financiare, do të analizohen mundësitet buxhetore, se a mund të realizohet ky vendim dhe si do të realizohet, a do të ndihmohen vetëm njerëzit me sëmundje të rënda kronike dhe rastet me gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale. Qendra e Mjekësisë Familjare në lagjen e 'Dardanisë', do të fillon punën me datën 21.04.2021. Këtë vitë vërvshimet kanë qenë të mëdha dhe kanë shkatuar shumë dëme nëpër shtëpi të banimit, ne e kemi rregulluar shtratin e lumit Sitnica, me përmirësimin e kohës, do të analizojmë pikat kyqe ku duhet të intervenojmë. Pagesat e punëtorëve shëndetësorë do të bëhen

në mënyrë retroaktive, po është e vërtetë që tetë mjekë kanë shkuar në specializime, andaj ne jemi në vështirësi dhe duhet ta analizojmë gjendjen dhe të ndërmarrim masat e duhura. Për kafiteritë tek Stadiumi i qytetit e dijmë gjendjen dhe aty duhet të intervenojnë organet kompetente, siç është Inspektorati dhe Policia.

**Ali Ismaili:** Unë e kërkoj një sqarim sepse nuk jemi ftuar për pjesëmarrje, në ceremonin për të nderuar dëshmorët dhe martirët e lirisë së Kosovës.

**Nënkryetari i Komunës:** Kjo ka ndodhur tani, unë besoi se herave tjera do të kemi një kujdes më të madh, siç ka qenë traditë edhe në vitet e kaluara. Bibliotekat funksionojnë nëpër qytete të mëdha, te ne mund të mirren librat nga lexuesit, konkursi është zhvilluar sipas procedurave, ju nuk duhet të mirreni më shkrime të portaleve, por me informatat zyrtare që jipen në ueb-faqën e komunës. Është e drejtë ekskluzive e Kryetarit të Komunës që të emëron drejtorë të ri, tani Drejtor për Arsim është emëruar z. Adnan Bullatovci, Drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport z. Fatlum Berisha dhe Drejtor për Inspektorat z. Besnik Hykollı.

**Mirvete Gërguri:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë këtu dua të reagoi për moszbatimin e kriterit gjinorë.

#### **Pika e katërt (4) - Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2020.**

**Kryesuesja e kuvendit të Komunës:** Theskoj se meqë këto pika janë të ndërlidhuar, ju ftoi që t'i bashkojmë diskutimet nëse jeni dakort. Anëtarët e Kuvendit të Komunës u pajtuan njëzëri që diskutimet për pikën e katërt dhe të pestë të rendit të ditës, të bëhen së bashku.

#### **Pika e pestë (5) - Propozim për shqyrtimin e Raportit Financiar për buxhetin e shpenzuar në vitin 2020.**

**Kryesuesja e kuvendit të Komunës:** Lidhur me reportin financiar për buxhetin e shpenzuar në vitin 2020, e ftoi Drejtorin e Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit që të na jap sqarime.

**Drejtori për Financa dhe Buxhet:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Raporti financiar për shpenzime në periudhën dymbëdhjetë mujore, është realizuar duke u mbështetur në Ligjin për menaxhimin e parasë publike Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, rregulloreve të Thesarit dhe konform nëntëmbëdhjetë standardeve të kontabilitetit. Ndërtimi i rapportit financiar është bërë në bazë të parasë së gatshme, ku janë kryerë të gjitha pagesat për transaksione ekonomike, borxhet e pagesat tjera të ndërtuara në raportet mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore. Mënyra e prezantimit të shpenzimeve nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit për secilën drejtori përkatëse, në këtë formë të detajizuar është model për shumë komuna, kësaj radhe ne i kemi zbërthyerë dhe sqaruar shumë quartë edhe shpenzimet e realizuara, nga fondi i rezervës dhe mjetet tjera financiare, që janë ndarë nga rimëkëmbja ekonomike për menaxhimin e pandemisë. Mjetet financiare të alokuara në Administratën Komunale janë në shumë prej: 7,687,758.66€, mjetet financiare të shpenzuara janë në shumë prej: 5,196,657.89€ dhe mjetet financiare të zotuara dhe të lira janë në shumë prej: 2,491,100.77€, mjetet financiare të alokuara në Arsim janë në shumë prej: 5,081,360.08€, mjetet financiare të shpenzuara janë në shumë prej: 4,651,112.96€ dhe mjetet financiare të zotuara dhe të lira janë në shumë prej: 430,247.12€, mjetet financiare të alokuara në

Shëndetësi janë në shumë prej: 2,364,426.06€, mjetet financiare të shpenzuara janë në shumë prej: 1,978,551.43€ dhe mjetet financiare të zotuara dhe të lira janë në shumë prej: 385,874.63€ dhe mjetet financiare të alokuara në Zyrën e Komuniteteve janë në shumë prej: 30,226.84€, mjetet financiare të shpenzuara janë në shumë prej: 29,516.30€ dhe mjetet financiare të zotuara dhe të lira janë në shumë prej: 710.54€. Shpenzimet e realizuara për menaxhimin e pandemisë janë bërë nga kodet ekonomike 00099 dhe 00098 që hyn në kuadër të shpenzimeve të përgjithshme, për pagë shtesa, mallëra e shërbime dhe subvencione e transfere, po ashtu gjatë vitit 2020 janë bërë edhe shpenzime për mësuesit, ku mjetet financiare janë ekzekutuar nga thesari përmes përmbaruesit privat, nga dy kategori ekonomike mallëra e shërbime dhe investime kapitale, në shumë të mjeteve financiare prej: 498,943.42€. Buxheti i alokuar me mjetet financiare të bartuara nga viti paraprakë, përbëhet nga kjo strukturë e të hyrave sipas fondeve burimore, ku alokimet janë në shumë të mjeteve financiare prej: 15,163,771.64€, ndërsa në përqindje nga grandi qeveritarë 68.18%, të hyrat vetjake 15.80%, salldo e bartur 16.81%, participimi i qytetarëve 0.80%, donacionet 0.05% dhe huamarrja nga Qeveria 0.36%. Në mjetet e shpenzuara financiare janë në shumë prej: 11,855,838.58€ sipas fondeve burimore kemi këtë përqindje të shpenzimeve, nga grandi qevritarë 78.09%, të hyrat vetjake 7.50%, salldo e bartur me 13.53%, participimi i qytetarëve 0.42%, donacionet 0.05% dhe huamarrja nga Qeveria 0.41%. Mjetet financiare të shpenzuara nëpër kategori ekonomike të shprehura në përqindje janë si vijon: për rroga dhe paga 42.01%, për mallëra dhe shërbime 17.13%, për shpenzime për komunali 2.27%, për subvencione dhe transfere 9.23% dhe për investime kapitale 29.36%. Në total buxheti i alokuar dhe i bartuar është shpenzuar 78.18%. të hyrat vetjake të planifikuara kanë qenë në shumë të mjeteve financiare prej: 2,809,510.00€, ndërsa është grumbulluar shuma e mjeteve financiare prej: 2,967,202.04€, kemi patur një tejkalim në shumë prej: 157,692.45€ ose 5.61% mbi planifikimin.

**Aida Alimi:** Për raportin e punës së Kryetarit të Komunës nuk do të flasim, sepse ai nuk po e respekton Kuvendin e Komunës, ndërsa në raportin finanziarë të shpenzimeve, kemi si zakonisht promuatacion të kodeve në shpenzime, që krijon një hapësirë për shpenzimin jo të drejtë të buxhetit.

**Durim Hajra:** Diskutimin lidhur me pikën e katërt për raportin e punës së Kryetarit të Komunës, ne do ta bojkotojmë për arsyet e mospjesëmarries së tij, edhe kur shqyrtohet rapporti vjetor i punës. Ne çdoherë nga Drejtori i Financave dhe Buxhetit i dëgjojmë fjalët, se shpenzimet janë të rregullta dhe kryhen në bazë të standardeve të kontabilitetit, por aty ku barten si të pa shpenzuara mbi tre milion euro, nuk mund të kemi menaxhim dhe shpenzim të mirë të buxhetit dhe kemi promutacion të shpenzimeve nëpër kode ekonomike. Ne kemi shpenzime enorme në Zyrën e Kryetarit të Komunës, për karburante janë shpenzuar 2,900.00€, për shërbime kontraktuese tjera janë shpenzuar 4,000.00€. Pyes, pse shpenzohen kaq shumë mjetë financiare për qiranë e pajisjeve të teknologjisë informative, në shumë Drejtori të Komunës e keni shpenzimin për frunizim me ushqim dhe pije, dreka zyrtare, ku në kohën e luftimit të pandemisë Covid - 19 është shpenzuar shuma e mjeteve financiare prej: 20,000.00€, njësoi është shpenzuar edhe për karbuarnte të veturave dikun një shumë prej: 20,000.00€, këto shpenzime në këtë kohë të vështirë janë, të pa pranueshme dhe të pa arsyeshme. Në Zyrën e Kuvendit të Komunës është një shpenzim prej:

2,367.50€ për dreka zyrtare. Shpenzimet për vendimet e gjykatave janë nëpër kode të ndryshme ekonomike, me shuma prej: 19,000.00€, 4,000.00€, 20,000.00€ dhe 3,000.00€, pastaj në Infrastrukturën Publike e kemi një shpenzim në shumë të mjeteve financiare prej: 3,500.00€, për akomodim dhe udhëtim jashtë vendit në kohën e pandemisë. Për shërbime kontraktuese tjera dhe dreka zyrtare janë shpenzuar 88,000.00€. tek kapitalet në Infrastrukturën Publike e kemi një shpenzim me emërtimin, qentë-asis. në ruajtje të sigurisë në shumë të mjeteve financiare prej: 23,985.00€. Në Zhvillimin Ekonomik, për shërbimet e mirëmbajtjes dhe riparimin e automjeteve, është shpenzuar shuma e mjeteve financiare prej: 3,500.00€, gjithësej për mirëmbajtje janë shpenzuar 20,500.00€. Për pandeminë janë shpenzuar gjithsej 211,000.00€, pagesa individuale në kulturë dhe për barna në shëndetësi. Nga Administrata e Arsimit për vendimet e gjykatave janë marrë 61,000.00€, për mësimin online janë shpenzuar 5,686.00€, ndërsa krahasuar me vitin 2019, në vitin 2020 janë shpenzuar gjithsej 1,284,000.00€, ndërsa në vitin 2018 mbi dy milion euro, këto shpenzime janë të larta, sepse kemi qenë në pandemi. Për blerjen e druve po ashtu, në vitin e pandemisë janë shpenzuar gjithsej 130,000.00€, që me vlerën e tregut i bjen se janë blerë 4807m<sup>3</sup> dru për shkolla.

**Drejtori për Financa dhe Buxhet:** Këto shpenzime janë të rrumbullakësuara, unë i kam sqaruar qartë të gjitha kësaj rradhe, më gjerësish, shpenzimet për ushqim dhe pije, këtu hyn edhe Çerdhja e Fëmijëve, shpenzimet në fillim të pandemisë nga vendimi i Kuvendit të Komunës në shumë prej: 404,000.00€, ku janë ndihmuar familjet në nevojë, këto mjetë financiare i kemi shpenzuar në pesë shtylla, ku hyn edhe dezinfektimi i rrugëve, hyrje/daljeve të ndërtesave, objekteve shëndetësore dhe arsimore, pakot ushqimore, pakot higjenike e sanitare, pastaj në shpenzimet e naftës hyn të gjithë sektorët e komunës, shëndetësia dhe arsimi, këtë e kemi sqaruar shumë herë. Përveç shpenzimeve nga fondi i rezervës nga moszbatimi i ligjit për paga në shumë të mjeteve financiare prej: 699,000.00€, këtu prapë hyn edhe shpenzimet e ndara nga Bashkimi Evropian për menaxhimin e pandemisë komunave, në shumë të mjeteve financiare prej: 302,000.00€.

**Durim Hajra:** kërkoi që këto shpenzime të vërtetohen vetëm në një kod si është, mirëmbajtja dhe riparimi i automjetve për vitet 2018, 2019 dhe 2020 dhe ato shpenzime të krahasohen.

**Ali Ismaili:** Unë do të flas shkurt këto dy pika raporti i punës dhe raporti financiarë i shpenzimeve, së bashku me propozimin për miratimin e buxhetit, janë pikat më të rëndësishme për shqyrtim brenda një viti kalendarik, por kur shqyrtohen këto pika mungon serioziteti. Ju e dini që unë në fillim të mandatit, kam nxjerrë të dhëna për shpenzimet e shkollave, për rrymë, ujë, mbeturina dhe telefona, sepse kur i kam parë, kam vlerësuar se janë të larta, kam marrë disa sqarime pse kjo punë është kështu, por edhe vetë kam bërë hulumtime nëpër shkolla dhe kam biseduar me Drejtoret e shkollave për këto shpenzime. Disa objekte kanë qenë të mbyllura në pranverë dhe kanë punuar me stafë të reduktuar, ndërsa shpenzimet e realizuara në vitin e kaluar në shumë fusha janë të larta dhe të pa arsyeshme. Votimi pë rose kundër është e drejtë e imja, por unë kam kërkuar dezinfektimin e objekteve fetare, aty ku janë njerëzit tanë, gjyshërit tanë dhe kjo punë nuk është realizuar.

**Mirvete Gërguri:** Shpenzimi i më shumë mjeteve financiare për telefona fiks, se sa për rrymë në shkolla, unë nuk di si mund të arsyetohet në këtë kohë, apo këtu kemi të bëjmë me borxhe të vjetra.

Ligji shkollat i lejon që t'i kryejnë procedurat e prokurimit vetë, deri në një mijë euro, pse kjo punë nuk bëhet në shkollat tona.

**Driton Ademi:** Unë ua kam thënë dhe dua të t'ua rikujtoi se në ditën e votimit të buxhetit sipas kodeve ekonomike dhe programeve të prezantuara, se kështu nuk duhet të jetë, fajt i keni vetë, po ashtu edhe bartja e mjeteve financiare të pa shpenzuara bëhet bllanko, pa sqarime konkrete. Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim ‘Propozimin përmiratimin e Raportit Financiar për buxhetin e shpenzuar në vitin 2020’.

U votua me: nëntë vota ‘për’, dy ‘kundër’ dhe një abstenim, gjithsej dymbëdhjetë anëtarë që marrin pjesë në votim, ndërsa të pranishëm në mbledhje janë shtatëmbëdhjetë anëtarë.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, në mungesë të pjesëmarrjes në votim nuk e kalon propozimin në fjalë.

**Pika e gjashtë (6) - Propozim përmiratimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-Rregullores për organizimin, bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** E kemi për shqyrtim ‘Propozimin përmiratimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-Rregullores për organizimin, bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës’, ftoi përfaqësuesit e subjekteve politike që t'i japid propozimet e tyre për anëtarë të Grupit Punues. Hap diskutimin.

**Ilir Hasani:** Përshtendes të pranishmit në mbledhje. Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës për anëtarë të Grupit Punues për hartimin e ‘Projekt-Rregullores për organizimin, bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës’, i propozojmë anëtarët e Kuvendit të Komunës si vijon: Sabri Rexhepi, Ali Zogiani dhe Albert Jasharaj.

**Doruntina Jashari:** Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosoje për anëtarë të Grupit Punues për hartimin e ‘Projekt-Rregullores për organizimin, bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës’, i propozojmë anëtarin e Kuvendit të Komunës: Durim Hajra.

**Aida Alimi:** Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, në Grupin Punues për hartimin e ‘Projekt-Rregullores për organizimin, bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës’, do të jem unë.

**Driton Ademi:** Unë kërkoi që sipas regullave të shfuqizohet vendimi i vitit të kaluar.

**Ali Ismaili:** Pajtohem me mendimin e parafolësitë tim, që duhet të shfuqizohet vendimi i marrë në vitin e kaluar.

**Driton Ademi:** Pyes, pse vitin e kaluar nuk ka punuar ky Grup punues?

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** Arsyja e vetme ka qenë pandemia, ju të gjithë e dini se vitin e kaluar është punuar me staf të reduktuar.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim ‘Propozimin për shfuqizimin e vendimit të vitit të kaluar, për caktimin e Grupit Punues për hartimin e Rregullores për organizimin, bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës’.

U votua me: tetë vota ‘për’, shtatë ‘kundër’ dhe asnjë abstenim, gjithsej pesëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave e aprovoi ‘Propozimin për shfuqizimin e vendimit të vitit të kaluar, për caktimin e Grupit Punues për hartimin e Rregullores për organizimin, bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës’ dhe mori:

#### V E N D I M

Për shfuqizimin e vendimit Nr. 73, të datës 10.06.2020, për caktimin e Grupit Punues për hartimin e Rregullores për organizimin, bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, në përbërje prej njëmbëdhjetë anëtarëve.

**Migjen Kolshi:** Kjo mënyrë e trajtimit të çështjes nuk është në rregull dhe paraqet një papërgjegjësi të pozitës në rastin konkret.

**Nënkyetari i Komunës:** Meqë ju nuk po i jepni propozimet e juaj, unë për anëtarë të këtij Grupi Punues i propozoi edhe Hysni Hasani nga radhët e komuniteteve dhe Maliq Thaçi nga Shoqëria Civile.

Pasi sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim ‘Propozimin për formimin e Grupit Punues për hartimin e Rregullores për organizimin, bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës’, në përbërje prej këtyre anëtarëve: Sabri Rexhepi, Ali Zogiani, Albert Jasharaj, Durim Hajra, Aida Alimi, Hysni Hasani, Jakup Ternava, Ekrem Berjani, Fatlum Berisha, Hasan Gjyrevci dhe Maliq Thaçi. U votua me: trembëdhjetë vota ‘për’, asnjë ‘kundër’ dhe asnjë abstenim, gjithsej trembëdhjetë anëtarë që marrin pjesë në votim, ndërsa të pranishëm në mbledhje janë shtatëmbëdhjetë anëtarë. Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, në mungesë të pjesëmarjes në votim nuk e kalon propozimin në fjalë.

**Pika e shtatë (7) - Propozim për formimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** Propozim për formimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

**Ilir Hasani:** Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës për anëtarë të Grupit Punues për hartimin e ‘Projekt-Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës’, i propozojmë anëtarët e Kuvendit të Komunës si vijon: Sabit Bullatovci, Miranda Shabani dhe Jetmir Berisha.

**Doruntina Jashari:** Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje për anëtarë të Grupit Punues për hartimin e ‘Projekt-Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës’, e propozojmë anëtarët e Kuvendit të Komunës: Eglantina Azemi.

**Aida Alimi:** Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës për anëtarë të Grupit Punues për hartimin e ‘Projekt-Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës’, e propozojmë anëtarët e Kuvendit të Komunës: Arjana Zogjani.

Pas diskutimeve për anëtarë të këtij Grupi punues u propozuan edhe: Migjen Kolshi, Suhat Ademi dhe Maliq Thaçi.

Pasi sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim ‘Propozimin për formimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës’, në përbërje prej këtyre anëtarëve: Sabit Bullatovci, Miranda Shabani, Jetmir Berisha, Eglantina Azemi, Arjana Zogiani, Migjen Kolshi, Suhat Ademi, Antigona Sahiti, Fatime Ismajli, Bahrije Hasolli, Hasan Gjyrevci, Adnan Bullatovci, Parayll Zogiani, Mobere Pllana dhe Maliq Thaçi.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej katërmëbëdhjetë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstataoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave e aprovoi ‘Propozimin për formimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës’, në përbërje prej pesëmbëdhjetë anëtarëve si vijon: Sabit Bullatovci, Miranda Shabani, Jetmir Berisha, Eglantina Azemi, Arjana Zogiani, Migjen Kolshi, Suhat Ademi, Antigona Sahiti, Fatime Ismajli, Bahrije Hasolli, Hasan Gjyrevci, Adnan Bullatovci, Parayll Zogiani, Mobere Pllana dhe Maliq Thaçi dhe mori:

#### V E N D I M

1. Për caktimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, në përbërje prej pesëmbëdhjetë anëtarëve si vijon:
  - 1.1 Sabit Bullatovci - Përfaqësues i Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtar;
  - 1.2 Miranda Shabani - Përfaqësuese e Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtar/e;
  - 1.3 Jetmir Berisha - Përfaqësues i Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtar;
  - 1.4 Eglantina Azemi - Përfaqësuese e Lëvizjes Vetëvendosje, anëtar/e;
  - 1.5 Arjana Zogiani - Përfaqësuese e Partisë Demokratike të Kosovës, anëtar/e;
  - 1.6 Migjen Kolshi - Përfaqësuesi i Iniciativës Qytetare të Fushë-Kosovës, anëtar;
  - 1.7 Suhat Ademi - Përfaqësues i Partisë Liberale të Egjiptianëve, anëtar;
  - 1.8 Antigona Sahiti - Shefe e Planifikimit Urban, anëtar/e;
  - 1.9 Fatime Ismajli - Zyrtare e Planifikimit Urban, anëtar/e;
  - 1.10 Bahrije Hasolli - Shefe e Zyrës Ligjore, anëtar/e;
  - 1.11 Hasan Gjyrevci - Zyrtar i Lartë për Kuvend dhe Komitete, anëtar;
  - 1.12 Adnan Bullatovci - Udhëheqës në Drejtoren e Arsimit, anëtar;
  - 1.13 Parayll Zogiani - Zyrtar për Leje ndërtimore, anëtar;
  - 1.14 Mobere Pllana - Zyrtare për Projektim dhe mbikëqyrje, anëtar/e dhe
  - 1.15 Maliq Thaçi - Përfaqësues i Shoqërisë Civile, anëtar.

**Pika e tetë (8) - Propozim për formimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-Rregullores për Shërbime publike dhe Projekt-Rregullores për menaxhimin e varrezave.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** Propozim për formimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-Rregullores për Shërbime publike dhe Projekt-Rregullores për menaxhimin e varrezave.  
**Ilir Hasani:** Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës për anëtarë të Grupit Punues për hartimin e dy projekt-rregulloreve: ‘Projekt-Rregullores për Shërbime publike dhe Projekt-Rregullores për menaxhimin e varrezave’, i propozojmë anëtarët e Kuvendit të Komunës si vijon: Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës, Remzi Shala dhe Arjeta Jashari.

**Durim Hajra:** Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje për anëtarë të Grupit Punues për hartimin e dy projekt-rregulloreve: ‘Projekt-Rregullores për Shërbime publike dhe Projekt-Rregullores për menaxhimin e varrezave’, e propozojmë anëtaren e Kuvendit të Komunës: Doruntina Jashari.

**Arjana Zogjani:** Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës për anëtarë të Grupit Punues për hartimin e dy projekt-rregulloreve: ‘Projekt-Rregullores për Shërbime publike dhe Projekt-Rregullores për menaxhimin e varrezave’, e propozojmë anëtaren e Kuvendit të Komunës: Aida Alimi.

Pas diskutimeve për anëtarë të këtij Grupi punues u propozuan edhe: Migjen Kolshi, Hysni Hasani dhe Maliq Thaçi.

Pasi sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim ‘Propozimin për formimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-Rregullores për Shërbime publike dhe Projekt-Rregullores për menaxhimin e varrezave’ në përbërje prej këtyre anëtarëve: unë Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës, Remzi Shala, Arjeta Jashari, Doruntina Jashari, Aida Alimi, Migjen Kolshi, Hysni Hasani, Maliq Berisha, Ejup Qyqalla, Nexhat Bajçinca, Drita Reçica, Milaim Shala, Bardhyl Kojçiçi, Hasan Gjyrevci dhe Maliq Thaçi.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej pesëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave e aprovoi ‘Propozimin për formimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-Rregullores për Shërbime publike dhe Projekt-Rregullores për menaxhimin e varrezave’, në përbërje prej pesëmbëdhjetë anëtarëve si vijon: unë Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës, Remzi Shala, Arjeta Jashari, Doruntina Jashari, Aida Alimi, Migjen Kolshi, Hysni Hasani, Maliq Berisha, Ejup Qyqalla, Nexhat Bajçinca, Drita Reçica, Milaim Shala, Bardhyl Kojçiçi, Hasan Gjyrevci dhe Maliq Thaçi dhe mori:

#### V E N D I M

1. Për caktimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-Rregullores për Shërbime Publike dhe Projekt-Rregullores për menaxhimin e varrezave, në përbërje prej pesëmbëdhjetë anëtarëve si vijon:
  - 1.1 Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës, përfaqësuese e Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtar/e;
  - 1.2 Remzi Shala - Përfaqësues i Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtar;
  - 1.3 Arjeta Jashari - Përfaqësuese e Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtar/e;
  - 1.4 Doruntina Jashari - Përfaqësuese e Lëvizjes Vetëvendosje, anëtar/e;
  - 1.5 Aida Alimi - Përfaqësuese e Partisë Demokratike të Kosovës, anëtar/e;
  - 1.6 Migjen Kolshi - Përfaqësuesi i Iniciativës Qytetare të Fushë-Kosovës, anëtar;
  - 1.7 Hysni Hasani - Përfaqësues i Partisë Demokratike të Ashkalinjëve të Kosovës, anëtar;
  - 1.8 Maliq Berisha - Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Mjedis, anëtar;
  - 1.9 Ejup Qyqalla - Shef për Shërbime Publike, anëtar;
  - 1.10 Nexhat Bajçinca - Zyrtar i Lartë i Makinerisë, anëtar;
  - 1.11 Drita Reçica - Zyrtare Ligjore, anëtar/e;
  - 1.12 Milaim Shala - Zyrtar për ujësjellës dhe kanalizime, anëtar;
  - 1.13 Bardhyl Kojçiçi - Shef për Planifikimin e Buxhetit, anëtar;
  - 1.14 Hasan Gjyrevci - Zyrtar i Lartë për Kuvend dhe Komitete, anëtar dhe
  - 1.15 Maliq Thaçi - Përfaqësues i Shoqërisë Civile, anëtar.

**Pika e nëntë (9) - Propozim për plotësimin e Komitetit për Komunitete.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** E kemi për shqyrtim, ‘Propozimin për plotësimin e Komitetit për Komunitete me një anëtarë të ri, duke e zëvendësimin përfaqësuesin e komunitetit egjiptian. Hap diskutimin.

**Driton Ademi:** Kjo punë nuk duhet të bëhet kështu, me pagesën e një euros në Zyrën Pritëse, për ta realizuar zëvendësimin, kjo punë duhet të bëhet sipas procedurës së paraparë. Pasi sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim ‘Propozimin për plotësimin e Komitetit për Komunitete, për zëvendësimin e përfaqësuesit të komunitetit egjiptian z. Bashkim Krasniqi me anëtarin e ri z. Hasim Avdullahi’.

U votua me: katërmbëdhjetë vota ‘për’asnje ‘kundër’ dhe një abstenim, gjithsej pesëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave e aprovoi ‘Propozimin për plotësimin e Komitetit për Komunitete, për zëvendësimin e përfaqësuesit të komunitetit egjiptian z. Bashkim Krasniqi me anëtarin e ri z. Hasim Avdullahi’ dhe mori:

**V E N D I M**

1. Për ndryshimin e vendimit Nr. 63, të datës 06.04.2018, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, lidhur me përbërjen e Komitetit për Komunitete.
2. Përfaqësuesi i subjektit politikë nga Partia Liberale Egjiptiane z. Bashkim Krasniqi pas kalimit të tij në Shërbimin Civil të Komunës së Fushë-Kosovës, zëvendësohet me përfaqësuesin e komunitetit egjiptian, anëtarin e ri z. Hasim Avdullahi.


**Pika e dhjetë (10) - Të ndryshme.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** E kemi pikën ‘Të ndryshme’, ftoj anëtarët e Kuvendit të Komunës që të marrin fjalën, nëse kanë ndonjë çështje për diskutim.

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 14:15 minuta.**

Procesmbajtës

Hasan Gjyrevcı



Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha

